



Prishtinë, 29 prill 2014
Kodi i ZRRE-së: V_620_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 03/L-185);
- Nenin 16 paragrafi 4 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Kërkesën për shtyrje të afatit për instalimin e gjeneratorëve të Erës, që përbëhet prej dy (2) turbinave , secila me nga 450kW, me kapacitet total prej 900kW, në lokacionin “Bostan”, KK Novobërdë, të datës 16.04.2014, të shoqërisë “Wind Power” SH.A., me adresë: Bulevardi i Dëshmorëve nr. 72/8B, Prishtinë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 29 prill 2014 nxori këtë:

V E N D I M

- I. OBLIGOHET** “Wind Power” SH.A që deri me 15 tetor 2014 të përfundojë instalimin e gjeneratorëve me Erë, që përbëhet prej dy (2) turbinave, secila me nga 450kW, me kapacitet total prej 900kW, në lokacionin “Bostan”, KK Novobërdë, të lejuar me Vendimin për Lëshimin e Autorizimit V-299-2010 të datës 11 nëntor 2010.

A r s y e t i m

- ZRRE me datë 16.04.2014 nga shoqëria “**Wind Power**” SH.A. ka pranuar kërkesën për shtyrjen e afatit për instalimin e gjeneratorëve të erës që përbëhet prej dy (2) turbinave, secila me nga 450kW, me kapacitet total prej 900kW, në lokacionin “Bostan”, KK Novobërdë.
- Bordi i ZRRE-së, me datë 11 nëntor 2010 pas vlerësimit të aplikacionit të shoqërisë “Wind Power” SH.A., dhe plotësimit të të gjitha kushteve dhe dëshmive plotësuese të kërkuara, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore, ka lëshuar Vendimin për Autorizimin V-299-2010, për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga Era, që përbëhet prej dy (2) turbinave, secila me nga 450kW, me kapacitet total prej 900kW, në lokacionin “Bostan”, KK Novobërdë.
- Me Vendimin për Autorizim Final është autorizuar shoqëria “Wind Power” SH.A., që të ndërtoj kapacitetet gjeneruese në lokacionin e lartë cekuar, sipas kushteve dhe afate të përcaktuara me Autorizim.
- Vendimi për Lëshimin e Autorizimit është lëshuar në afatin dy (2) vjeçar, duke filluar nga data e lëshimit të tij, ku ka sqaruar se me kërkesë të palës, mund të vazhdohet vlefshmëria e autorizimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Në kërkesën për shtyrje të afatit për instalimin e gjeneratorëve të erës, shoqëria “Wind Power” SH.A., ka arsyetuar se për shkak të vështirësive të mëdha financiare nuk kanë arritur t’i instalojnë gjeneratorët në lokacionet e lartcekura, të përcaktuar në bazë të Autorizimit, pasi



që, për një kohë të gjatë nuk është arritur marrëveshja me “KEK” SH.A, gjegjësisht “KEDS” SH.A., rreth nënshkrimit të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë. Pas arritjes së Marrëveshjes për Blere të Energjisë me “KEDS” SH.A. në bazë të tarifës së rregulluar për gjeneratorët e erës të instaluar në Golesh, Wind Power SH.A., ka rishfaq interesimin për vazhdimin e instalimit të turbinave të erës në Bostan, KK Novobërdë.

- Në arsyetimin e saj, sqaron se bazamentet e turbinave dhe të gjitha përgatitjet për montimin dhe instalimin e gjeneratorëve në fjalë janë të kryera, ku i posedon të gjitha lejet e nevojshme, kushtet teknike janë realizuar duke filluar nga ndërtimi i bazamenteve shtrirja (trasimi) e kablllove për kyçje, ndërtimi i trafo dhe i kthinës, montimi i njehsorit matë etj. Poashtu edhe gjeneratorët janë të transportuar në vendin e ngjarjes, ku vetë duhet të montohen dhe instalohen.
 - Gjithashtu ka sqaruar se montimi i gjeneratorëve të erës është specifik sepse duhen vinça të mëdhenj, e që montimin duhet me realizuar vetëm një kompani nga Maqedonia, ku duhet kohë përafërsisht 3-4 muaj të bëhen parapërgatitje. Poashtu edhe kushtet atmosferike ndikojnë në montimin e gjeneratorëve.
 - Në bazë të kësaj çka u tha më lartë shoqëria “Wind Power” SH.A., ka kërkuar shtyrje të afatit deri më 15 tetor 2014, për instalimin dhe montimin e gjeneratorëve.
 - ZRRE pas analizimit të kërkesës për shtyrjen e afatit për instalimin e gjeneratorëve të erës që përbëhet prej dy (2) turbinave, secila me nga 450kW, me kapacitet total prej 900kW, në lokacionin “Bostan”, KK Novobërdë, ka vlerësuar ato dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Pas kalimit të afatit për instalimin e gjeneratorëve të erës, të përcaktuar me këtë vendim. Vendimi V_299_2010 i datës 11 nëntor 2010 mbi Vendimin Lëshimin e Autorizimit, do të shfuqizohet.
- III. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare,

Krenar Bujupi, anëtar.